

VENDIM
Nr.838, datë 24.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV TATA JUNIOR”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të zonave të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.780, datë 25.2.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë shoqërisë “TATA JUNIOR” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor, në fushën e transmetimeve kabllore për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në qytetin e Bajram Currit.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)